



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4386/Prot.

Tiranë, më 09.07. 2024

URDHËR

NR. 348, DATË 09.07.2024

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË,
DOKTORATË NË “SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE
NDËRKOMBËTARE”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT NË TIRANË DHE
UNIVERSITETIN “ISTANBUL SABAHATTIN ZAIM” TË STAMBOLLIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 77, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrin nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, që do të zhvillohet në gjuhën angleze, me kod P83DO0312A.
Studimet e doktoratës të zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/ve bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e përbashkët e gradës shkencore “Doktor” në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë dhe Fakultetin respektiv në Universitetin “Istanbul Sabahattin Zaim” të Stambollit, referuar nivelit 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e përbashkët të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të respektojë kriteret për personelin akademik të angazhuar për programin e studimit, lidhur me numrin maksimal të udhëheqjeve që mund të

kenë në të gjitha IAL-të, në varësi të titullit akademik që zotëron udhëheqësi, në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut në Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ



Konceptoi:	A. Manja
Pranoi: 2.7.2024	A. Gjini
Miratuan:	B. Biçoku
	V. Koçi
Konfirmuan:	J. Çollaku
	E. Tola
Data e shkresës tek SP:	04.07.2024
Nr. i kopjeve të shkresës:	6